Zgjedhja e lëndës fetare ose e lëndës së pikëpamjes mbi jetën dhe çregjistrimi prej saj

Arsimi fillor në Vantaa 2023

Regjistrimi në shkollë dhe kërkesa për lëndën rreth fesë ose pikëpamjen e jetës

Kur fëmija regjistrohet në shkollë, kërkohet për të mësuar lëndën rreth fesë ose pikëpamjen e jetës:

1. Feja ungjillore luterane
2. Njohuri për pikëpamjen e jetës
3. Feja ortodokse
4. Feja budiste
5. Feja islame
6. Feja katolike
7. Feja e lëvizjes Krishna

Nëse asnjëra nuk është zgjedhja e duhur, atëherë nuk bëhet zgjedhja, por kontaktohet drejtori i shkollës.

A është fëmija një anëtar i kishës ungjillore luterane apo i kishës ortodokse?

Nëse fëmija është anëtar i kishës (fesë) ungjillore luterane ose ortodokse, **kujdestari mund të zgjedhë vetëm fenë sipas besimit të tij**.

A është fëmija anëtar i një komuniteti fetar të regjistruar në Finlandë?

Ky është informacion i rëndësishëm.

Nëse nuk është, kujdestari mund të zgjedhë nga sa vijon:

1. Një fe që korrespondon me kulturën e familjes
2. Njohuri për pikëpamjen e jetës
3. Feja e shumicës, pra feja ungjillore luterane

A është fëmija anëtar i një komuniteti fetar të regjistruar në Finlandë?

Nëse fëmija është anëtar i një komuniteti tjetër fetar të regjistruar në Finlandë, përveç fesë luterane ungjillore apo ortodokse, kujdestari mund të zgjedhë nga sa vijon:

1. Feja që mësohet në shkollë, në të cilën është regjistruar fëmija
2. Njohuri për pikëpamjen e jetës
3. Feja e shumicës, pra feja e luteranëve ungjillorë
4. Mësimdhënia që zëvendëson lëndën e fesë apo njohurin për pikëpamjen e jetës (për përmbajtjen e mësimit vendos shkolla individualisht)

A mund të aplikohet për kompensim nga çregjistrimi prej mësimit?

Kujdestari mund të aplikojë për kompensim nga arsimi i çregjistruar bazuar në faktin se nxënësi ndjek mësimin fetar në komunitetin e tij. Mund të merrni formularin për aplikim nga shkolla juaj dhe nga faqja e internetit në

vantaa.fi

Nëse jepet çregjistrimi nga mësimi, duhet të paraqitet në shkollë dëshmia e anëtarësimit në komunitet dhe e pjesëmarrjes në mësim. Mësimdhënia në komunitet nuk vlerësohet me notë në çertifikatën e shkollës. Në informacionin shtesë të çertifikatës, tregohet se nxënësi ka marrë pjesë në mësimdhënien në komunitetit e tij.

A mund të aplikohet për çregjistrim nga mësimi i lëndës së fesë ose lëndës së pikëpamjes së jetës ?

Kujdestari mund të aplikojë që studenti të çregjistrohet nga mësimi i lëndës. Ju mund ta merrni formularin nga shkolla juaj dhe nga faqja e internetit vantaa.fi

Nëse nxënësi ka studiuar një lëndë, fenë ose pikëpamjen e jetës në shkollë, nuk jepet çregjistrimi sepse mësimi i dhënë nga bashkësia e tij fetare nuk është bazë për këtë çregjistrim.

Zgjedhja është e përhershme

Zgjedhja e lëndës së fesë ose lëndës pikëpamjes rreth jetës është e përhershme. Zgjedhja mund të ndryshohet nëse komuniteti fetar i regjistruar në Finlandë ndryshon, ose studenti nuk i përket më asnjë komuniteti fetar.